



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr.02/127

Datë: 10.03.2023

Në mbështetje të nenit 13 dhe 68 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 të dt. 04.06.2008), Statutit të Komunës nr. 06/1636 të dt. 03.09.2008, Udhëzimit Administrativ nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna, Kryetari i Komunës me datën merr këtë:

### VENDIM

- I. Emërohet grupi punues për konsultimet publike në Komunën e Shtimes me këtë përbërje:
  - I.1. Lulzim Sahiti – Zyrtar i Lartë për Informim – Kordinator;
  - I.2. Lulzim Muharremi – Zyra Ligjore;
  - I.3. Miftar Miftari – Zyrtar i IT;
  - I.4. Valon Januzi – DAP;
  - I.5. Albana Fazliu – DKRS;
  - I.6. Bardhyl Rushiti – DShP;
  - I.7. Isa Haxhiu – DSHMS;
  - I.8. Grejtalb Emini – DPUKGJP;
  - I.9. Kastriot Shabani – DZHE;
  - I.10. Bujar Ferati – ZKF;
  - I.11. Yllka Fejzullahu – DKA.
- II. Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projektpropozimit, i cili i nënshtrohet procesit të konsultimit publik para aprovimit të tij.
- III. Zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është i obliguar të zbatoj të gjitha dispozitat e parapara të konsultimit publik me udhëzim, së bashku me detyrat dhe përgjegjësitë e parapara me nenin 9 të UA nr. 06/2018.

- IV. Zyrtari përgjegjës përgatit raporte vjetore për procesin e konsultimit publik në Komunë, raporton tek Kryetari i Komunës dhe në njësinë përgjegjëse për monitorim të komunave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dorëzohet:

- Kryetarit të Komunës;
- Anëtarëve të grupit punues;
- DAP-it;
- Arkivit.

Kryetari i Komunës  
Qemajl Aliu



The image shows a circular official stamp in blue ink. The text around the perimeter of the stamp reads "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top, "KOMUNAE SHITES" on the left, "PUSHTETI LOKAL" on the right, and "SHTIME-SHTIMLJE" at the bottom. In the center of the stamp is a small emblem of the Republic of Kosovo. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink, which appears to be "Qemajl Aliu".